



REPUBLIKA E KOSOVES / REPUBLIC OF KOSOVO	
MINISTRIA E MJEDISIT, PLANIFIKIMIT HAPËSINOR DHE INFRASTRUKTURËS MINISTARSTVO ŽIVOTNE SREDINE, PROSTORNOG PLANIRANJA I INFRASTRUKTURE MINISTRY OF ENVIRONMENT, SPATIAL PLANNING AND INFRASTRUCTURE	
Njësia.org. Org.Jednica Org.Unit	011111
Nr i Faqeve Br.Stranica No.Pages	09
Nr i Prot. Broj Prot. Prot. No	2285-2/23
Datë Datum	12.05.23
PRISHTINË / A	
No.1	

Republika e Kosovës
Republika Kosovo - Republic of Kosovo
Qeveria - Vlada - Government

*Ministria e Mjedisit, Planifikimit Hapësinor dhe Infrastrukturës
Ministarstvo Životne Sredine, Prostornog Planiranja i Infrastrukture
Ministry of Environment, Spatial Planning and Infrastructure*

Për:	Bali Muharremaj, Kryetar i Komunës së Suharekës Bexhet Kuqi, Kryesues i Kuvendit të Komunës së Suharekës
Kopje:	Elbert Krasniqi, Ministër i MAPL Trim Berisha, Zëvendësues i Sekretarit të Përgjithshëm të MAPL Njësia për Administrimin e Dokumenteve në MAPL
Përmes:	Liburn Aliu, Ministër i MMPHI Servet Spahiu, Zëvendësues i Sekretarit të Përgjithshëm të MMPHI
Nga:	Florije Kika, Drejtore e Departamentit Ligjor
Zyrtarët përgjegjës:	Nr. VL-136/23 Datë: 11.05.2023
1.Zyrtari konfirmues vlerësimit ligjor	Sabrije Rama, Udhëheqëse e Divizionit për Mbikëqyrjen e Zbatimit të Legjislacionit të
2.Zyrtari hartues vlerësimit ligjor	Mbështetjes Ligjore dhe të Bashkëpunimit Ndërinstitucional në Fushën e Legjislacionit
Lënda:	Vlerësimi i ligjshmërisë së aktit komunal
Lloji i aktit:	Vendimi Nr.016-27354 për iniciimin e procedurave për hartimin e planit rregullues të hollësishëm për zonën industriale në Shirokë, miratuar nga KK Suharekë.

I nderuari Kryetar, Muharremaj,
I nderuari Kryesues, Kuqi,

Ministria e Mjedisit, Planifikimit Hapësinor dhe Infrastrukturës, në pajtim me Rregulloren (QRK) Nr. 06/2021 për ndryshimin dhe plotësimin e rregullores (QRK) Nr.10/2019 për shqyrtimin administrativ të akteve të komunave, ka pranuar nga MAPL, Vendimin Nr.016-27354 për iniciimin e procedurave për hartimin e planit rregullues të hollësishëm për zonën industriale në Shirokë, miratuar nga KK Suharekë, miratuar nga KK Suharekë, datë 27.04.2023.

Ministria e Mjedisit, Planifikimit Hapësinor dhe Infrastrukturës, pas shqyrtimit të ligjshmërisë së aktit në fjalë, dhe në pajtim me Nenin 4 të Rregullores (QRK) Nr. 06/2021 për ndryshimin dhe plotësimin e rregullores (QRK) Nr.10/2019 për shqyrtimin administrativ të akteve të komunave, kërkon nga kuvendi i komunës së Suharekës, konstaton :

Rishqyrtimin e Ligjshmërisë së Aktit

Vendimi Nr.016-27354 për iniciimin e procedurave për hartimin e planit rregullues të hollësishëm për zonën industriale në Shirokë, miratuar nga KK Suharekë, datë 27.04.2023.

A r s y e t i m i

Ministria e Mjedisit, Planifikimit Hapësinor dhe Infrastrukturës, pas shqyrtimit të Vendimit Nr.016-27354 për iniciimin e procedurave për hartimin e planit rregullues të hollësishëm për zonën industriale në Shirokë, miratuar nga KK Suharekë, konstatoi se:

Vendimi Nr.016-27354 për iniciimin e procedurave për hartimin e planit rregullues të hollësishëm për zonën industriale në Shirokë, miratuar nga KK Suharekë, është plotësuar me Zonën Kadastrale sipas rekomandimeve të vlerësimit të ligjshmërisë së Vendimit Nr.016-14454 për iniciimin e procedurave për hartimin e Planit Rregullues të Hollësishëm në Shirokë, miratuar nga KK Suharekë, nr.prot.1121-2/23, datë 13.03.2023, mirëpo, është e domosdoshme që të vendosen edhe sipërfaqet sipas Hartës Zonale Komunale duke përfshirë edhe parcelat kadastrale në kuadër të këtyre sipërfaqeve.

Të veprohet sipas vlerësimit të ligjshmërisë së aktit komunal nga MMPHI, të merr vendim të drejtë dhe të ligjshëm në pajtim me dispozitat ligjore në fuqi, jo më vonë se afati i paraparë në dispozitat e nenit 9 të Rregullores (QRK) Nr. 06/2021 për ndryshimin dhe plotësimin e rregullores (QRK) Nr.10/2019 për shqyrtimin administrativ të akteve të komunave.



From: Suzana.Goranci
Sent: Thursday, May 4, 2023 9:19 AM
To: Xhemail Metolli <Xhemail.Metolli@rks-gov.net>
Cc: Burbuqe Hydaverdi <Burbuqe.Hydaverdi@rks-gov.net>; Labinota Jahja <Labinota.Jahja@rks-gov.net>; Sabrie Rama <Sabrie.Rama@rks-gov.net>
Subject: FW: Shkresë Përcjellse nga MAPL

Përshëndetje Drejtor,

Te poshtëshënuar gjeni vlerësimin profesional te shqyrtimit te ligjshmërisë

Gjitha te mirat,
Suzana

From: Burbuqe Hydaverdi
Sent: Wednesday, May 3, 2023 3:44 PM
To: Suzana.Goranci <Suzana.Goranci@rks-gov.net>
Cc: Xhemail Metolli <Xhemail.Metolli@rks-gov.net>
Subject: RE: Shkresë Përcjellse nga MAPL

Përshendetje Suzana,
Këto vendime janë shqyrtuar më herët dhe është kërkuar plotësimi i tyre si më poshtë:

Neni 1 i të 3 vendimeve duhet të plotësohet me të dhënat e Zonave Kadastrale dhe parcelat kadastrale që përfshihen në këto plane.

Neni 1 i Vendimit Nr.016-14451 për iniciimin e procedurave për hartimin e Planit Rregullues të Hollësishëm për “ Zonën Industriale” në Biraq, PRRH në Biraq (të plotësohet emërtimi), sepse si i tillë nuk përputhet me Hartën Zonale të Komunës. Në HZK parashihen PRRH-të për Zonën Industriale në Duhël, prandaj të plotësohet emërtimi.

Vërejtje:

Lidhur me sipërfaqet e parapara për hartimin e këtyre planeve me këto vendime, sipërfaqet janë të përcaktuara me Hartën Zonale të Komunës në fuqi dhe si të tilla duhet të respektohen.

Për informimin tuaj,

- *Vendimi për iniciimin e procedurave për hartimin e planit rregullues në fshatin Delloc* qenka anuluar-shfuqizuar me vendim nr. 016-27349 nga KK Suharekë për të cilin nuk mund të japim mendim.
- *Vendimi për iniciimin e procedurave për hartimin e planit rregullues të hollësishëm për zonën industrial në Shirokë,* është plotësuar me Zonën Kadastrale dhe parcelat kadastrale (në pamundësi për ti verifikuar të gjitha), ato duhet të jenë konform Hartës Zonale të miratuar nga KK Suharekë.
- *Vendimi për iniciimin e procedurave për hartimin e planit rregullues të hollësishëm për zonen ekonomike në Duhël* është plotësuar me Zonën Kadastrale dhe emërtimin, por parcelat kadastrale duhet të jenë konform Hartës Zonale të miratuar nga KK Suharekë.

Vërejtje:

Sipërfaqet e parapara për hartimin e këtyre planeve në vendimet e mëparshme janë larguar nga këto vendime, por konsideroj që këto sipërfaqet është dashur të qëndrojnë dhe si të tilla duhet të respektohen, ashtu siç janë të përcaktuara me Hartën Zonale të Komunës në fuqi. (bashkangjitur Harta e Planeve Rregulluese të Hollësishme).

Gjithë të mirat,
Buqja

From: Suzana.Goranci
Sent: Wednesday, May 3, 2023 11:16 AM
To: Burbuqe Hydaverdi <Burbuqe.Hydaverdi@rks-gov.net>
Cc: Xhemail Metolli <Xhemail.Metolli@rks-gov.net>
Subject: FW: Shkresë Përcjellse nga MAPL

Përshëndetje Buqe,

Te lutem te vlerësohet ne aspektin profesional shqyrtimi I vendimeve te ligjshmërisë

Gjitha te mirat,
Suzana

From: Sabrie Rama
Sent: Wednesday, May 3, 2023 10:37 AM
To: Xhemail Metolli <Xhemail.Metolli@rks-gov.net>
Cc: Suzana.Goranci <Suzana.Goranci@rks-gov.net>; Florije Kika <Florije.Kika@rks-gov.net>
Subject: FW: Shkresë Përcjellse nga MAPL